



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë

Datë 22.12.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (*titulli i projektvendimit*): **PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË TOTALE 50'572'489 (PESËDHJETË MILIONË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E DY MIJË E KATËRQIND E TETËDHJETË E NËNTË LEKË), PËR LIKUIDIMIN E PLOTË TË DISA FAMILJEVE DHE PËR LIKUIDIMIN ME KËST TË PJESËS TJETËR, TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË DATAVE 29.01.2025 – 30.01.2025**

Baza ligjore:

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit: “*Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme*”- *kodi i produktit 91707AB*,

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (*Çfarë propozohet në projektvendim*):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë totale 50'572'489 (pesëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025, e ndarë si më poshtë:

- a) Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë 6'592'545 (gjashtë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë për 89 familje, që do të likujdohen plotësisht, për të cilat vlera e dëmit të konstatuar është më e ulët se shuma e kësti për familjet që do të trajtohen me ndihmë financiar e ndarë në këste, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur.
 - b) Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë 43'979'944 (dyzet e tremilionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë për 342 familje, të cilat do të trajtohen me këste, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.
2. Dhënia e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025 do të përballohet nga:
- a) Fondi me vlerë 37'572'489 (tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, e cila do të merret nga fondi i papërdorur, i alokuar nga Ministria e Financës më shkresën me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit 91707AB, "*Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme*".
 - b) Diferenca prej 13'000'000 (trembëdhjetë milionë) lekë do të merret nga buxheti i Bashkisë Durrës, i dedikuar për programin "Emergjencat Civile", e cila vihet në dispozicion për përballimin e këtij procesi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fonde të papërdorura, alokuar nga Ministria e Financës dhe nga buxheti i bashkisë Durrës.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Impakti social/grupet që preken:

Banorë të bashkisë Durrës të dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm **Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë**, u mbledh më datë 22.12.2025, dhe shqyrtoi pikën nr.4 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë

	Pozicioni	Emër Mbiemër	Firma
1	Kryetar	Mirela Shala	
2	Zv/Kryetar	Xhiliola Doçi	
3	Sekretar	Zhuljeta Ngota	
4	Anëtar	Rolant Xhelilaj	
5	Anëtar	Ervis Bekteshi	